

V E N D I M
Nr.112, datë 13.8.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““
Petrit Plloçi,	Anëtar i	“““
Tefta Zaka,	Anëtare e	“““
Sokol Sadushi	Anëtar i	“““
Gjergj Sauli,	Anëtar i	“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 11.8.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.118 Akti që i përket:

KËRKUES:LLESH KOLA, kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitore” në zonën zgjedhore nr.13 Lezhë, përfaqësuar nga avokatët Mirash Martini e Agim Ibrahim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. NIKOLLË LESI, përfaqësuar nga avokat Përparim Sanxhaku, me prokurë.
3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.13 LEZHË, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.220, datë 8.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.13

BAZA LIGJORE: Neni 141 i Kodit Zgjedhor

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, kërkuesin e përfaqësuesit e tij, subjektet e interesuara, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.78, datë 9.7.2001, shfuqizoi vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.012, datë 1.7.2001 për shpalljen e rezultatit përfundimtar të votimit në zonën zgjedhore nr.13 Lezhë dhe urdhëroi përsëritjen e zgjedhjeve të cilat u zhvilluan rregullisht në datën 29.7.2001.

Kërkuesi Llesh Kola, bazuar në nenin 108 të Kodit Zgjedhor në datën 31.7.2001, kërkoi të kryhej rinumërimi i fletëve të votimit nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Komisioni i zonës zgjedhore nr.13, pas përfundimit të procesit të rinumërimit të fletëve të votimit nga gjykata, shpalli fitues kandidatin Nikollë Lesi. Brenda afatit ligjor, kërkuesi u ankua kundër këtij vendimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, por ky komision, me vendimin nr.220, datë 8.8.2001, shpalli rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve dhe njohu fitues kandidatin Nikollë Lesi.

Me ankimin e paraqitur për shqyrtim, kërkuesi Llesh Kola e konsideron të paligjshëm vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.220, datë 8.8.2001, duke pretenduar se gjykata ka shkelur dispozitat e Kodit Zgjedhor, sepse ka lejuar rinumërimin e fletëve të votimit në kutitë e hapura dhe në zarfet e hapura, ka quajtur të vlefshme fletët e votimit që kanë pasur shenja, se nuk ka bërë krahasimin e numrit të fletëve të votimit të përdorura me numrin e votuesve ose se ka quajtur të vlefshme votimet me certifikatë pa fotografi etj.

Pretendimet e mësipërme të kërkuesit u bënë objekt i shqyrtimit gjyqësor, por nuk rezultoi që

prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Lezhës të jetë kryer ndonjë proces jo i rregullt ligjor. Përkundrazi, nga procesverbali i mbajtur prej kësaj Gjykate, që shqyrtoi çështjen e rinumërimit të votave në periudhën 2-4 gusht 2001, rezultoi se ajo ka pasur parasysh pretendimet e kërkuarit dhe për to është shprehur me vendim. Ky fakt tregon se gjykata në këtë proces ka ushtruar të gjitha kompetencat ligjore të përcaktuara në dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimet e saj, sipas pikës 2 të nenit 112 të këtij Kodi, janë të formës së prerë.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese konkludon se kërkesa e paraqitur prej kërkuarit është e pabazuar dhe si e tillë duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 shkronja “e” e 132 të Kushtetutës, neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 141 pika 1 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.